

**AKTI I THEMELIMIT  
DHE  
STATUTI I SHOQËRISË  
Ginger Tirana SHPK**

**THEMELIMI**

**Neni 1**

**Ortaku themelues**

- 1.1 Shoqëria **Ginger Tirana SHPK** themelohet nga **Ortaku i Vetëm Znj. Enkelejda Beshiri**, shtetase Shqiptare, lindur me 15.08.1976 ne Tirane, me rezidence Tirane, mbajtese e Pasaportes me numer BA2406210 dhe Nr. Personal H65815060D.

**EMËRTIMI, SELIA, FORMA LIGJORE**

**Neni 2**

**Emërtimi**

- 2.1 Emërtimi i shoqërisë është **Ginger Tirana**

**Neni 3**

**Forma ligjore**

- 3.1 Shoqëria është e formës me përgjegjësi të kufizuar dhe është themeluar në përputhje me legjislacionin tregtar në Shqipëri.
- 3.2 Shoqëria mund të shndërrohet në një formë tjetër në përputhje me legjislacionin shqiptar.

**Neni 4**

**Baza ligjore**

- 4.1 Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me këtë Statut, me Aktin e Themelimit, legjislacionin tregtar dhe dispozita të tjera ligjore.

**Neni 5**

**Kohëzgjatja e veprimtarisë**

- 5.1 Veprimtaria e shoqërisë fillon me regjistrimin e saj në Qendren Kombetare te Biznesit ("QKB").
- 5.2 Afati i veprimtarisë së shoqërisë për një afat të përcaktuar.

**Neni 6**

**Selia**

- 6.1 Selia shoqërisë është në adresën: Njesia Bashkiake Nr. 2, Rruga Murat Toptani, Qendra e Biznesit "Gjergj Center" Kati 1 – Tirane.
- 6.2 Ortaku i vetëm i shoqërisë mund të vendosë të hapë degë dhe/ose filiale dhe/ose adresa sekondare dhe/ose zyra përfaqësimi të shoqërisë si brenda territorit të Shqipërisë ashtu dhe jashtë saj ose mund të rregjistrojë ato ekzistuese sipas ligjeve ne fuqi.



- 6.3 Shoqëria mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen në Shqipëri dhe/ose jashtë saj me vendim të Ortakut të Vetëm të shoqërisë.

#### **Neni 7**

##### **Emblema. Vula**

- 7.1 Shoqëria do të ketë emblemen dhe vulën e saj. Vula do të përdoret nga administratorët e shoqërisë.  
7.2 Forma dhe përmasat e vulës do të përcaktohen në përputhje me rregullat e legjislacionit shqiptar.  
7.3 Të gjitha dokumentet e shoqërisë duhet të përmbajnë emblemen dhe vulën e saj.

#### **Neni 8**

##### **Objekti**

- 8.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është: **“Bar – Kafe, Restorant”**  
8.2 Objekti i shoqërisë mund të ndryshohet me vendim të Ortakut të Vetëm.

#### **Neni 9**

##### **Kapitali**

- 9.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 100'000 Lekë (Njëqind mijë Leke).  
9.2 Ortaku i Vetëm zotëron 1 (një) kuotë, e cila është e barabartë me vlerën e kapitalit të shoqërisë.  
9.3 Kapitali është shlyer tërësisht.

#### **Neni 10**

##### **Transferimi i pjesëve të kapitalit. Kufizimet.**

- 10.1 Kuotat mund të transferohen tek të tretët në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” me amendimet perkatëse të tij.  
10.2 Vendosja e çfarëdolloj barre mbi kuotat në favor të palëve të treta do të lejohet vetëm me pëlqimin e Ortakut të Vetëm.

#### **Neni 11**

##### **Rritja e kapitalit**

- 11.1 Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet ose zvogëlohet me vendim të Ortakut të vetëm.  
11.2 Zmadhimi i kapitalit mund të bëhet gjithashtu edhe nëpërmjet nënshkrimit dhe shlyerjes së pjesëve të tjera të kapitalit nga ortakë të rinj. Ortakët e rinj pranohen dhe miratohen si të tillë me vendim të Ortakut të Vetëm.

#### **Neni 12**

##### **Zvogëlimi i kapitalit**

- 12.1 Zvogëlimi i kapitalit bëhet sipas procedurave të parashikuara nga legjislacioni tregtar.  
12.2 Propozimi i zvogëlimit do t'i paraqitet ekspertit kontabël të autorizuar dhe administratorit të paktën 45 ditë përpara marrjes së vendimit nga Ortaku i Vetëm i shoqërisë. Eksperti kontabël dhe administratori do të shqyrtojnë propozimin dhe do t'i paraqesin ortakut të vetëm raportin në lidhje me arsyet dhe kushtet e zvogëlimit të kapitalit.  
12.3 Raporti i zvogëlimit të kapitalit do të miratohet me vendim të Ortakut të vetëm të shoqërisë.



## ORGANET E SHOQËRISË

### Neni 13

#### Vendimet e ortakut të vetëm

- 13.1 Vendimet kryesore mbi veprimtarinë e shoqërisë merren nga Ortaku i Vetëm i saj.
- 13.2 Vendimet e Ortakut të Vetëm përfshijnë kryesisht:
- Përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë;
  - Ndryshimin e emërimit të shoqërisë;
  - Zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë;
  - Prishjen dhe/ose likuidimin e shoqërisë;
  - Emërimin ose shkarkimin e administratorit ose administratorëve të shoqërisë si dhe përcaktimin e shpërblimit për ta;
  - Emërimin ose shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar si dhe përcaktimin e shpërblimit për ta;
  - Miratimin e bilancit të shoqërisë e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise së veprimtarisë;
  - Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - Transformimin e shoqërisë në forma të tjera;
  - Të drejta dhe detyrime të tjera të parashikuara nga legjislacioni tregtar në fuqi.

### Neni 14

#### Administrimi

- 14.1 Administrimi i shoqërisë kryhet nga një administrator ose një grup administratorësh që caktohen me vendim të Ortakut të Vetëm.
- 14.2 Administratori ka të drejtë të përfaqësojë shoqërinë dhe drejtojë punën e përditshme të shoqërisë në përputhje me udhëzimet e Ortakut të Vetëm.
- 14.3 Administratori i shoqërisë është **Znj. Brunilta Karaj**, shtetase Shqiptare, lindur më 22.04.1983 në Tiranë, me rezidence ne Tiranë, mbajtëse e Letërnjoftimit Nr. 032263293 dhe Nr. Personal I35422101T.
- 14.4 Administratori është përgjegjës për veprimtaritë e mëposhtme:
- Drejtimin e veprimtarisë së përditshme të shoqërisë;
  - Përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhëniet me të tretët ose ne gjykim personalisht ose me përfaqësim;
  - Hartimin dhe mbajtjen e kontabilitetit;
  - Emërimin e ekspertëve kontabël të autorizuar, në qoftë se është e nevojshme;
  - Përgatitjen e nenshkrimit e dokumentave në emër të shoqërisë sipas kompetencave që zoteron;
  - Zhvillon veprimtari të tjera të cdo lloj natyre për të mirën e shoqërisë dhe realizimin e objektit të saj sipas udhezimeve te Ortakut te Vetem;
  - Administratori i shoqerise eshte i perjashtuar nga e drejta e marrjes se kredive bankare nga aktiviteti ne fushen e investimeve dhe berja e shpenzimeve tej aktivitetit te zakonshem te shoqerise.
  - Administratori nuk ka asnje tager per te kryer transaksione, terheqje apo veprime te tjera qe lidhen me levizjet bankare ne llogarite e shoqerive prane cdo banke te nivelit te dyte ne Republiken e Shqiperise. Te gjitha te tagrat dhe te drejtat per te kryer ne menyre te pakufizuar transaksione, terheqje apo veprime te tjera qe lidhen me levizjet bankare ne llogarite bankare te shoqerise prane cdo



banke te nivelit te dyte ne Republiken e Shqiperise do i perkasin Ortaku te Vetem te shoqerise Znj.Enkelejda Beshiri.

- Administratori mund ti delegeje te drejtat e veta fillimisht njerit prej ortakeve ose me pas nje personi te trete (kur shoqeria mbetet me nje ortak te Autorizuar me shkrim per te perfaqesuar shoqerine si dhe te kryej veprime dhe praktika te ndryshme ne emer te tij)
- Administratori ka te drejte te ndermarre cdo veprimtari tjetër ose biznes ose aktivitet i cili konsiderohet i nevojshme per biznesin e shoqerise ne Shqiperi sipas urdhezimeve te Ortakut te Vetem.

14.5 Mandati i administratorit do të jetë i vlefshëm për 5 (pesë) vjet me të drejtë ripërtëritje ose deri në castin e revokimit të tij me vendim të Ortakut të Vetëm.

#### **Neni 15**

##### **Viti financiar**

- 15.1 Viti financiar i shoqërisë përputhet me vitin kalendarik, duke filluar nga 1 Janari dhe mbaruar më 31 Dhjetor të cdo viti.
- 15.2 Si përjashtim, viti i parë financiar i shoqërisë do të fillojë nga dita e regjistrimit të shoqërisë në Zyren e Tatim Taksave dhe përfundon më 31 Dhjetor të po atij viti.

#### **Neni 16**

##### **Bilanci. Kontabiliteti.**

- 16.1 Bilanci vjetor i shoqërisë shqyrtohet nga Ortaku i Vetëm dhe duhet të përgatitet për t'u paraqitur para organeve tatimore deri në fund të muajit mars të vitit pasardhës.
- 16.2 Kontabiliteti mbahet në gjuhën dhe monedhën shqiptare si dhe sipas kërkesave të legjislacionit perkates. Për operacione të vecanta, shoqëria mund të bëjë veprime edhe me llogari të vecanta në monedhë të huaj, duke bërë konvertimin brenda vitit.
- 16.3 Shoqëria mund të pranojë fonde nga institucionet financiare që operojnë në Shqipëri ose jashtë. Për këtë qëllim shoqëria mund të lërë peng pjesë të kapitalit si garanci ose mund të hipotekojë pasuritë e saj të paluajtshme, vetëm me vendim të Ortakut të Vetëm.

#### **Neni 17**

##### **Te Ardhurat. Dividendi**

- 17.1 Shoqeria do te krijojë fonde rezerve për realizimin e qellimeve të biznesit të saj në përputhje me kërkesat e ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" me amendimet perkatese.
- 17.2 Te ardhurat që do të rezultojnë në fund të mbylljes së cdo ushtrimori, pas pagimit të tatimeve, mund t'i kalojnë Ortakut të Vetëm.
- 17.3 Humbjet e shoqerise do te mbulohen deri ne kufirin e kapitalit themeltar dhe Ortaku i Vetëm do te pergjigjet deri ne kufirin e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise. Humbjet transferohen nga mbyllja e ushtrimorit te pare deri ne tre ushtrimoret vijues.

#### **Neni 18**

##### **Likuidimi**

- 18.1 Prishja e shoqërisë vendoset me vendimin e Ortakut të Vetëm të shoqërisë.

- 18.2 Me vendimin e Ortakut të Vetëm caktohet një likuidator ose një grup likuidatorësh që do të plotësojnë procedurat e likuidimit.
- 18.3 Likuidatori do të përgatisë raportin e likuidimit mbi gjëndjen ekonomike të shoqërisë, rreth operacioneve të mëtejshme të likuidimit dhe kohën që nevojitet për përfundimin e tij. Në përfundim të kësaj procedure, Ortaku i Vetëm do të shqyrtojë bilancin përfundimtar dhe do të miratojë përfundimin e procedurave të likuidimit.

#### **Neni 19**

##### **Mosmarrëveshjet**

- 19.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis shoqërisë dhe të tretëve, në rast se nuk zgjidhen me mirëkuptim do t'i nënshtrohen shqyrtimit nga gjykata kompetente shqiptare.

#### **Neni 20**

##### **Klauzolë mbyllëse**

- 20.1 Ky Statut hartohet në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe me fuqi të njëjtë ligjore.

**Tirane më 01.07.2023**

**Ginger Tirana SHPK**

**Ortaku i Vetëm**

**Enkelejda Beshiri**

*Enkelejda Beshiri*

